



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 26, Datë 04.02.2026

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOVA SOLAR SYSTEM” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, dhe 13 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.02.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 7/6 prot., datë 30.01.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve *“Mbi kërkesën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”*,

Konstatoi se:

- Shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 7 prot., datë 06.01.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 06, datë 15.01.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.01.2026 dhe 17.01.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.01.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Gjithashtu njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 7/3 prot., datë 22.01.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin e munguar për këtë aplikim.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 7/4 prot., datë 22.01.2026 dhe nr. 7/5 prot., datë 26.01.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e munguar të aplikimit.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI